



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 19 datë 20.11.2019

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS
EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË
SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%)
PËR NDIHMËN EKONOMIKE.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 55, pika 2 të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës:

V E N D O S I:

- 1.Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

Sekretar i Këshillit

Denis Lesha

KRYETARE



KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).

| Nr. | KRITERET E PIKËZIMIT | PIKËT (Total 100) | DOKUMENT KONFIRMUES |
|-----|--|----------------------|--|
| 1 | Familje një prindërore me një ose më shumë fëmijë nën moshë pune | 19 | Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle |
| 2 | Familje me 3 apo më shumë fëmijë nën moshë pune | 17 | Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle |
| 3 | Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura) | 15 | Çertifikatë familjare |
| 4 | Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune. | 13 | Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor |
| 5 | Familje të ngjuara për gjakmarrje | 11 | Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit |
| 6 | Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit | 9 | Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor |
| 7 | Familje në proces divorci | 7 | Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata |
| 8 | Familje që kanë anëtar madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram | 5 | Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata |
| 9 | Familje të prekura nga fatkeqësite natyrore | 3 | Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë |
| 10 | Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike | 1 | Çertifikatë familjare |

Sekretar i Këshillit



Denis Lesha

KRYETARE



Brisela KABLLA